


Shtojca 2
Aplikacion për dhënie e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	Kompania „Shala Gas” shpk
	Vendi	Zona industriale Suharekë
	Adresa	Zona Industriale, Shirokë, rruga Ukë Bytyqi, p.n. Suharekë
	Nr. i tel./fax	+383 44 140 102
	E-mail	//
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Nr. unik identifikues: 811889213 Data e regjistrimit: 29.12.2021
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Afrim Shala
	Nr. i tel./fax	+383 44 600 767
	E-mail	//
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati
	Nr. i tel./fax	+383 49 655 661
	E-mail	edonak88@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	„Shala Gas” shpk
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Kompania „Shala Gas” shpk e cila si aktivitet kryesor ka deponimin dhe tregtimin e gazit lënget natyror (GLN) ne zonën industriale Shirok, Zona kadastrale Suharekë komuna Suharekës.

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT		
2.1	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Pozita gjeografike e lokacionit Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren, përmes analizave vizuale dhe informatave të marra nga ana e vetë personave përgjegjës të kompanisë “Shala Gas” Sh.p.k, në Shirokë komuna e Suharekës. Lokacioni i Deponis së gasit të lëngët naftor të kompanisë „Shala Gas” Shpk, ndodhet në rrugën Ukë Bytyqi, në Zonën industriale, në parcelën me Nr. P-72116046-02785-34, në vendin e quajtur Shiroko, zona kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë. Parcela në fjalë është pronë shoqërore e marrë në qirambajtje për 99 vite nga Kompania “Shala Gas” SH.P.K. Parcela ndodhet në kuadër të ashtuquajturit zonë industriale/park biznesi, e kufizuar edhe me veprimtari tjera afariste të shumta në kuadër të kësaj zone, konkretisht në anën e djathtë të rrugës rajonale Suharekë-Prizren. Kjo veprimtari apo kjo kompani operon me vite të tëra, për aktivitetin e deponimit të gasit të lëngët naftor, gjë e cila ka ardhur si rezultat i nevojave të vendit për produktin në fjalë. Kompania është vendosur në lokacionin të përshtatshëm, konkretisht në zonë industriale, në mënyrë që të mos paraqiten pengesa sidomos për popullatën e gjerë, që të evitohet qfarëdo lloj rreziku i mundshëm. Në kuadër të zonës industriale e cila sipas fletës poseduese, lloji i shfrytëzimit të parcelës është e tipit Bujqësor, ndërsa shfrytëzimi aktual është Kullosa, por tashmë lokacioni është i shëndrruar në zonë industriale, ku qdo ditë e më shumë po pasurohet me zhvillimin e aktiviteteve nga më të ndryshme. Pozita Gjeografike e deponis së gasit të lëngët naftor

		
		<i>Foto 3. Situacioni i Deponisë së gasit të lëngët naftor “Shala Gas” Shpk</i>
2.2	Numri kadastral i parcelës	Në parcelën me nr. P-72116046-02785-34, në vendin e quajtur Shiroko, në zonë industriale të Suharekës, komuna Suharekë.
2.3	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Në afërsi të drejtëpërdrejt ndodhet deponia e Oksigjenit në njërën anë, Deponi të rezervuarëve të naftës në anën tjetër, ndërsa në nga të dyja anët tjera kufizohet me rrugë. Në një distancë rreth 150 metra kalon autostrada “Ibrahim Rugova”, por që kjo zonë industriale nuk ka qasje direkte në këtë autostradë. Zona industriale ka qasje në rrugët e saj të cilat pastaj dalin në Shirokë dhe lidhjen me rrugën kryesore Suharekë –Prizren dhe autostraden “Ibrahim Rugova”. Në bazë të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin global të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë punës së deponisë së gasit të lëngët naftor. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme negative dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një veprimtari specifike sikurse është kjo e Deponisë së gasit të lëngët naftor. Për t’a pasur më të qartë vendodhjen e lokacionit, ky raport shoqërohet edhe me foton e mëposhtme si pamje satelitore dhe harta topografike.

2.4 .	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Parcela ku është e vendosur deponia për gasin e lëngët naftor është pronë shoqërore e marrë me qera nga kompania në fjalë, ku sipas fletës poseduese ka qenë tokë bujqësore, por që tani e gjithë zona ka ndërruar destinim dhe është shëndrruar në zonë industriale, andaj edhe nuk ka florë apo vegjetacion të zhvilluar në zonën në fjalë. Vlen të ceket se në anën e kundërt të rrugës, apo përballë kësaj deponie të gjitha parcelat kanë destinim të tokës bujqësore dhe shfrytëzohen si të tilla. Sipas të dhënave nga instituti i mbrojtjes së natyrës në këtë lokacion nuk ka ndonjë lloj bimor me rëndësi për mbrojtje. Ndërsa pronari ka të mbjella bimë frutore në pjesën më të madhe rreth parcelës. Zona në fjalë ka një peisazh të zakonshëm të një zone të banuar e rrethuar me toka bujqësore dhe nuk ekziston ndonjë status si zonë e mbrojtur. Flora dhe Fauna përreth zonës është tipike e një zonë të populluar si dhe me rritjen e aktivitetit mjaft të hovshëm dhe zhvillimit të industrisë në zonën në fjalë është larguar si flora edhe fauna poashtu. Me këtë zonë vërehet prania e bimëve kryesisht atyre barishtore, dhe shkurreve të tokave të lena djerrin, nga bimesia dominojnë bimët e familjes: <i>Fabaceae</i>, <i>Fagaceae</i>, <i>Rosaceae</i>, <i>Poaceae</i> etj. Ndërsa nga Fauna kemi lloje të ndryshme të zvarranikeve, pakurrizor të ndryshëm një numër të vogël të gjitarëve, zogje të ndryshëm të cilët lokacionin mund ta shfrytëzojnë si urë kalimi por jo edhe për jetesë. Sipërfaqet bujqësore ekonomike të komunës janë sipërfaqe të punuara (23.378 ha). Bujqësia është një ndër degët kryesore të kësaj komune. Sipërfaqja e punuar, respektivisht arat dhe kopshtet (12.918 ha) shfrytëzohen kryesisht për prodhimin e grunajave (grurit, misrit, elbit dhe thekrës), të bimëve industriale dhe perimeve (lule diellit, grosha dhe patatja) dhe bimëve për kafshë (tërfojea dhe jonxha). Pemishtet përfshijnë sipërfaqen prej 426 ha. Pemëtaria nuk është një degë aq e rëndësishme ekonomike. Në to kryesisht kultivohen kumbullat, mollët dhe qershizat. Suhareka ka kushte mjaft të mira për zhvillimin e vreshtarisë (1.703 ha) Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 2.753 ha ndërsa
-------	---	---

		kullosat 5.578 ha. Sipërfaqet e pashfrytëzuara ekonomike janë pyjet dhe zabelet. Gjendja ekzistuese e pyjeve dhe e fondit të pyjeve në këtë komunë edhe pse janë ndërmarrë masa me qëllim të kultivimit, kujdesit dhe zhvillimit të pyjeve, nuk janë aq të mira edhe pse kushtet janë mjaftë të volitshme. Sipërfaqeve pyjore përbëjnë 15,561 ha prej tyre 1600 ha janë pyje të larta. Pyjet e komunës së Suharekës shtrihen në lartësi mbidetare 455 m deri 1760 m. Këto pyje janë kryesisht pyje gjetshore (lisi dhe ahu), ndërsa haloret janë mjaft të pranishme. Si lloje përcjellëse të pyjeve lisore janë: shegët, gorniçet, dardhat e egra, etj.
2.5	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokacion kemi të bëjmë me hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore		
3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	<i>Shtojca 1</i>
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Deponia për gasin e lëngët naftor të kompanisë “Shala Gas” shpk e cila gjendet në vendin e quajtur Shiroko shtrihet në parcelën me një sipërfaqe prej 20453 m², ku sipërfaqja e cila shfrytëzohet për vendosjen e rezervuarëve përfshin rreth 10% të totalit të parcelës në fjalë. Në kuadër të funksionimit të tij kompania përfshin hapësirën: a) Objektin e administratës b) Hapësira për vendosjen e bombolave statike të gazit c) Hapësira për grumbullimin e bombolave dhe pjesëve të tyre d) Depo kryesore e gasit me rezervuarë e) Objekti për testimin dhe mbushjen automatike të bombolave f) Trafo elektrike personale 250 kW g) Pishina (Rezervuari) e ujit

- h) Rezervuari i naftës 5000 litra
- i) Parkingu i veturave
- j) Parkingu i mekanizmit (5 kamion dhe dy kombi)
- k) Rruga e kompleksit afarist
- l) Rruga kryesore
- m) Zona gjelbëruese
- n) Linja për mbushjen e bombolave
- o) Peshorja
- p) Rrethoja e lokacionit
- q) Sistemi mbrojtjes kundër zjarrit
- r) Hidrantët për fikje zjarri

Krahas strukturave përcjellëse, objekteve për funksionimin normal të depos së gasit të lëngët naftor, në lokacion ndodhet edhe separatori në formë rezervuari për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura, bunari filtrues, është e rregulluar platoja funksionale, e betonuar, poashtu ndodhet sistemi për barjten e ujrave.



Depoja e bombolave

Përfshin një hapësirë me një sipërfaqe rreth $A = 150 \text{ m}^2$

Halla industriale e cila duhet të shërbejë për deponi të bombolave të kapaciteteve vëllimore të ndryshme ku deponohen bombolat për treg.

		Objekti i Administratës Hapësira administrative kap një sipërfaqe bruto prej $A = 70\text{m}^2$, e cila në vehte përfshin katër zyre që i shërbejnë kompanisë “Shala Gas” SHPK, për mbarrëvajtje të punës. Reservuari i ujit Në kuadër të funksionimit të aktivitetit të deponisë së gasit të lëngët naftor, parashihet edhe ekzistimi i një pusete apo një rezervuar uji për rastet aksidentale nga ndonjë shpërthim eventual i zjarrit, andaj eksiton pishina me Vëllim prej $V = 50\text{ m}^3$ dhe sipërfaqe prej $A = 25\text{ m}^2$. 5.2. Platoja e kompleksit Sipërfaqja ku është e vendosur deponia e gasit të lëngët naftor është kryesisht në një teren të rrafshët, por kompania e ka mundur që të realizoj një pjerrtësi të vogël me qëllim që të bëhet e mundur përcjellja e ujërave sipërfaqësore të pjesës për rreth rezervuarve të deponis, objekteve përcjellës dhe objektit administrativ. Organizimi i rezervuarëve dhe përgjithësisht kësaj depo është i organizuar në një mënyrë të përshtatshme për funksionim sa më të mirë të makinerive dhe qasjen për hyrje dalje në rrugën kryesore që lidh rrugën rajonale Suharekë- Prizren si dhe kyçje në anën tjetër të rrugës transite. 5.3. Rezervarët e gasit natyror Në bazë të projektit ideor të ndërtimit dhe të gjendjes faktike të depos për gasin e lëngët naftor, si dhe vizitave në teren janë caktuar numri dhe kapacitetet e rezervuarëve të gasit që ndodhen në lokacionin e deponis dhe atë si vijon: 1. Rezervuar gasi $2 \times 150\text{ m}^3$ 2. Rezervuar gasi $2 \times 115\text{ m}^3$ 3. Rezervuar gasi $3 \times 100\text{ m}^3$ 4. Rezervuar gasi $4 \times 70\text{ m}^3$ 5. Rezervuar gasi $4 \times 60\text{ m}^3$
--	--	---

6. Rezervuar gasi 3 x 56 m³

7. Rezervuar gasi 1x 15 m³

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të gazta dhe të vendosur mbi tokë në pozitë horizontale, në hapësirën e betonuar të mbështetur në tri mbajtëset (shalat) nga betoni dhe të shtrënguara me nga dy shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforcimit për të mos lëviz nga ndonjë presionet i mundshëm.

Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve bëhet nëpër mes sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur apo kyçur drejt në rezervuar sikurse mund të shihen edhe nga fotot.



Foto 5. Disa prej rezervuarëve të gasit të vendosur në lokacion

Këta rezervuare të cilët janë të vendosur mbi sipërfaqen e nivelit të terrenit pranë objektit dhe nëpërmjet përçuesve të tubacionit nëntokësor janë të lidhur me automatet për toçitjen e gazit.

Automate janë të larguara nga depozitat mbitokësore në një distancë të mjaftueshme nga depozitat mbitokësore, ndërsa depozita e gazit

		prej automateve te gazit ka një distance sipas rregullave teknike, ndërsa automatet për toçitje prej objektit fqinje është ne një distance sipas kriterëve te kësaj lemie, distanca nga rruga kryesore deri te aparatet për toçitje është një distance ne përputhje me aktet ligjore te dala nga Ligji i Mbrojtjes nga Zjarri Nr.04/L-012. Hyrja ne platon e Depos se Gazit eshte mundësuar nga ana e djathte e kësaj rruge ne këtë deponi, ekzistojnë zonat e rrezikut sipas akteve ligjore me distance te mjaftueshme. Objektet për rreth janë te vendosura ne distance te mjaftueshme dhe nuk paraqesin rrezik, te gjitha keto jane ne harmoni me rregullat teknike qe rregullojnë këtë lemi. Duke i marre parasysh karakteristikat e gjendjes faktike në hapësirën e analizuar si dhe karakteristikat e potencialeve ekzistuese nga njëra anë dhe karakteristikave te objektit te impiantit nga ana tjetër është shtruar nevoja për hartimin e hulumtimit të veçantë studimor me ane te cilit do te përkufizoheshin te gjitha ndikimet relevante qe mund te paraqiten në relacionin deponi - mjedis jetësor, duke marre parasysh medoemos edhe rrethin e gjere. Qëllimi i kësaj kompanie përkatësisht biznesit në fjalë është ofrimi i shërbimeve të tregtimit me pakicë dhe për furnizim të mjeteve motorike.
--	--	--



Tërë sipërfaqja e operacionale brenda deponis së gazit natyror është e kufizuar me skajore betoni dhe qarkullimi i brendshëm është i shënuar në pllato ndërsa skajoret janë të ngjyrosura me ngjyrë të verdhë e kaltërt. Ujërat e mbledhura gjatë reshjeve kullohen deri në pusetat e kanalizimit atmosferik i cili është i lidhur deri në seperatorin. Grumbullimi i ujrave në separator bëhet për arsye ekologjike, pasi sipërfaqet e kësaj platoje shpesh janë të goditura nga elementet e vajrave të makinave të cilat mund të kenë rrjedhje. Konstruksioni i platos sikurse kemi cekur është nga betoni i armuar MB30, me armirim me armature rrjete në dy shtresa si dhe punimin

		e fugave ne distance sipas detalit, kjo shtrese vendoset mbi shtresën e tamponit nga zhavorri ne trashësi 35 cm i cili se pari është i ngjeshur. Shenjat horizontale dhe vertikale janë të plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore te cilat rregullojnë lemin e komunikacionit. Të gjitha stabilimentet dhe sistemet e tubacioneve janë të vendosura dhe te parallogaritura ne baze te situatave ndërtimore, te punuara ne baze te detyrës projektuese dhe ne përputhje me rregullat për ndërtimin e objekteve për karburante të Gazit, si dhe deponimin dhe zbrazjen e tyre. Karburantet (Gazi) transportohen me ndihmën e autocisternave, kurse zbrazja e tyre behet me rrënje te lire ne depozitore (rezervuare) apo depozita për deponim nga të cilat me ndihmën e pompave adekuate behet furnizimi i makinave te shfrytëzuesve te gazit natyror. Për deponimin e karburanteve te Gazit janë vendosur rezervarët mbitokësorë te punuar nga lllamarina e çelikut sipas DIN 6608 me mbështjellës te dyfishuar. Ofrimi i dritares kontrolluese te rezervuarëve është zgjedhur nëpërmes puseve të muratuara me dimensione 1000 x 1000 mm. Ne kapakun e dritares kontrolluese te depozitorit (rezervuarit) janë te vendosura lidhjet për mbushje, zbrazje - matje, ajrim. Rezervuari është i vendosur ne dy mbështetje prej betonit. Rezervuari është i ngjyrosur me material antikorodues. Tërë pajisja ne rezervuar është ne „Ex" mbrojtje antiexplozive. Rezervuari është i tokëzuar dhe përmban mbrojtjen nga rrufeja. Sistemi ndaj zjarrit për rezervuarët përbehet se paku prej 1 hidranti, por në mungese te hidrantëve ato zëvendësohen me numër te caktuar te aparateve për shuarjen e zjarrit, sistemit për dërgimin e ujit ne rezervuar si dhe aparatet për shuarje te zjarrit P50 dhe P9 si ne situacion. Autocisternat për zbrazjen e propan butanit kane shuarësin e shkëndijave si dhe tokëzimin.
--	--	---

		Mbushësi i gazit është ngritur nga rrethina dhe dysHEMEJA është e realizuar prej betonit me lyerje që nuk shkëndijon (qet xixa). Afër gjinden edhe aparatet P9 dhe P50. Janë tabelat e kujdesit në të cilat duhet të jenë të dhënat: - Ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i zjarrit të hapur; - Rrezik nga zjarri dhe eksplozimi; - Përdorimi i obliguar i pajisjeve të cilat nuk shkaktojnë xixa (nuk shkëndijojnë); - Cisterna e kyçur; - Gaz i rrezikshëm. Pika e gasit të lëngët naftor posedon: • Një depozitë të gazit horizontale të një kapaciteti të caktuar • Lloji i valvulës me sustë • Numri i fabrikës • Diametri nominal DN24 • Fluidi punonjës 16 bar • Valvula e rregulluar në presion 17 bar • Bllombimi i valvulës siguruese Deposita e gasit është e vendosur në jastëkët e vet prej metali në pjesën e shtruar me beton në të njëjtën mënyrë është e rregulluar edhe vendosja e pompës për distribuim të gasit Në furnizim me gas duhet të punojnë punëtor të cilët janë të trajnuar dhe duhet të jenë të certifikuar për punë me materie të rrezikshme-gas të certifikuar nga agjensioni i menaxhimit të emergjencave, apo ndonjë firmë që është e licencuar në aspektin e mbrojtjes nga zjarri nga AME. Secili rezervuar duhet të posedoj pasaportën dhe direktivat udhëzuese për përdorim që i posedon pronari. Në zonën mbrojtëse nuk guxojnë të gjenden burime termike, materiale ndezëse dhe pajisje tjera që nuk i përkasin depozitat. Aparatet për toçitje mbrohen nga burimet termike me anë të një
--	--	--

sistemi ftohës, kurse nga zjarri me sistem hidrantësh dhe aparate speciale për shuarjen e zjarrit.

Rezervuarët parashihen me standarde me sa vijon:

- Kyqja në fazën e thatë NO 50 NP25 për mbushje
- Kyqja në fazën e thatë NO 50 NP25 për zbrazje
- Kyqja në fazën e gazët NO 50 NP25 për zbrazje
- Kyqja në fazën e gazët NO 50 NP25 për mbushje
- Kyqja e fazës së zbrazjes NO 50 NP25 për lidhje kthyese

Karakteristikat e gasit - gasi i lëngët në këtë deponi është përzierje e propan butanit 60% -40%, në kushte normale është në gjendje të gazët por me presion të shtuar shndërrohet në gjendje të lëngët. Gasi është produkt me erë të fortë dhe më i rëndë se ajri , prandaj grumbullohet në pika më të ulëta të tokës, të tubacioneve tjera., mund të shkaktoj helmime, demtoj organet e frymëmarrjes, të pamurit dhe të shkaktoj edhe vdekjen në sasi të larta ku konsentrimi i oksigjenit bie nën 18%.







Foto 7. Depoja me rezervuare e shpërndare ne dy rende, objekti ku behet testimi bombolave dhe mbushja automatike e bombolave, pishina me ujë, objekti garazhe dhe depo për mjete të ndryshme.

Procesi teknologjik- i manipulimit me gas bëhet në tri sisteme:

- Sistemi për zbrazje të gasit
- Sistemi për deponim të gasit
- Sistemi për shitje të gasit

Sistemi për zbrazje nënkupton sjelljen e karburantit në deponi, ku mjetet transportuese stacionohen në vendin e paraparë në kuadër të platos manipulative. Tubacionet që përbëjnë pjesën e palëvizshme të impiantit mund të jenë prej Çeliku, Bakri, Polietileni.

Bashkimet e tubave të çelikut duhet të jenë sipas rekorderive me filetaturë sipas standardit UNI ISO 7/1, nëpërmjet saldimeve kokë më kokë, me shkrirje.

Grumbullimi i mbeturinave të lëngëta bëhet në seperatorin të vajit, stacioni i gasit është i pajisur me rrufepritis, kurse depozita e gasit është e tokëzuar në pajtim me normat në fuqi.

Shpërndarja e rrjetit të tubacioneve-rrjeti i tubacionit është i vendosur mbi tokë përmes shtyllave të betonuara dhe janë të

		mbrojtura nga korrozioni. Pajisjet matëse me rezervuarët janë të ndërlidhura me ndihmën e tubave të zinkuar pa tegel, këto lidhje duhet të kontrollohen vazhdimisht. Secili Rezervuar ka hapjen hyrëse, mbërthyeset për përforcim dhe kyqjet. Rezervuarët kanë këto shënime: Emrin e prodhuesit, të fabrikës, vitin e prodhimit, vëllimin nominal dhe të vërtet, llojin e lëndës djegëse, shenja e standardit DIN. Rreziku nga zjarri nuk është shumë i madh me gasin e lëngët naftor në kushtet normale të punës dhe kur temperature e lëndës djegëse dhe e ambientit sillet nën 303K. Por përzierja e avullit të lëngët dhe lëngut të lëndës djegëse mund të ndizet: Me flakë të hapur, me hark elektrik, me thermit e kuqur dhe shkëndi. Lënda djegëse e gasit ka nxehtësi të lartë volumetrike, kështu që edhe sasi të më të vogla, nëse ndizen mund të jenë shumë të rrezikshme. Në rast të zjarreve të vogla, lokale, në fillim të shfaqjes së tyre zjarri fiket nga punëtori me aparat doracak, ndërsa në rast të shfaqjes së zjarrit më të madh, duhen njësi të specializuara, që të thirret shërbimi profesional i zjarrfikësve. Rreziku më i madh i shfaqjes së zjarrit mund të vie në rast se ngritet temperaturat e ambientit mbi 313K. Linja për testimin dhe mbushjen e bocave të vogëla të gasit – bocat që vijnë nga klientet fillimisht ju bëhet shkarkimi i gazit mbeturinë apo vajit ato hodhën në rezervuarin separator, pastaj bocat e pastruara me ujë dhe ju bëhet testimi i tyre në shtypje 25 bar. Nëse bocat e kalojnë testimin të njëjtat mbushen me gas, ndërsa ato që nuk e kalojnë testimin shkatërrohen dhe hodhën si mbeturinë. Bocat pas kalimit të testit mbushën në mënyrë automatike vendosen në linjën e mbushjes e cila ka një kapacitet deri në 500 boca në ditë me vëllim të bocës 3-60 litra.
--	--	---

		5.4. Karakteristikat kryesore të procesit teknologjik në deponine e gasit Procesi teknologjik në stacionin deponis se gasit të lëngët naftor përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mesë vete. • Sistemi për zbrazje • Sistemi për deponimin e karburanteve • Sistemi për dhënien (toçitjen) e karburanteve Sistemi për deponim te gazit përbehet prej një depozite te një kapaciteti $V = 30.000$ litrave, me propan-butan gas. Matja e sasise se deponuar ne depozite matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse te vendosura ne autocisterne ose përmes levës se bozhdaruar dhe tabelave te veçanta për do ndarje te depozitës. Sistemi për dhënien apo toçitjen e karburanteve të lëngëta (GLN) përbehet nga një pajisje automatike me nga dy gypa për toçitje gjithsej dy gypa për toçitje. Sistemi për dhënie te karburanteve janë te mbrojtur nga rreziku eventual.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Hënë - Premte Orari i punës 08:00 – 17:00 E shtunë Orari i punës 08:00 - 14:00
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	• Rezervuar gasi $2 \times 150 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $2 \times 115 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $3 \times 100 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $4 \times 70 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $4 \times 60 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $3 \times 56 \text{ m}^3$ • Rezervuar gasi $1 \times 15 \text{ m}^3$

		Ndërsa kapaciteti i realizuar nuk mund të dihet, sepse kjo varet nga nevojat e klientëve dhe asnjë ditë nuk mund të jetë e njëjtë sasia e shitjes së derivateve.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Komponentët hyrëse ne procesin teknologjik që zhvillohen ne stacionin e gazit janë: • Gasi natyror (Propan, butan, etan, propan) • Energjia elektrike • uji Gazi i lëngët naftor shërbejnë për furnizimin e automjeteve, për nevoja në amvisni dhe në industri, etj. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim te pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike behet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike dhe trafo personale. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare për larjen e platos se stacionit te gazit dhe për furnizim te pajisjeve ndaj zjarrit. Nevoja e ujit për sanitari varet nga numri i punëtoreve p.sh. për një punëtor nevojiten 25 litra ujë ne dite. Furnizimi me ujë ne stacionin e gazit nga rrjeti i ujësjellësit, kurse uji i cili shfrytëzohet kryesisht për shpëlarje te pllatoe si dhe ujitjen e sipërfaqeve te gjelbëruara, dhe për furnizim te pajisjeve ndaj zjarrit do te behet nga pusi qe duhet nxjerr me shpim të thelle nga pronari.
3.1.6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	Në bazë të projektit ideor të ndërtimit dhe të gjendjes faktike të depos për gazin e lëngët naftor, si dhe vizitave në teren janë caktuar numri dhe kapacitetet e rezervuarëve të gasit që ndodhen në lokacionin e depos dhe atë si vijon: • Rezervuar gasi 2 x 150 m³ • Rezervuar gasi 2 x 115 m³ • Rezervuar gasi 3 x 100 m³ • Rezervuar gasi 4 x 70 m³ • Rezervuar gasi 4 x 60 m³

		• Reservuar gasi 3 x 56 m³ • Reservuar gasi 1x 15 m³ Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të gazta dhe të vendosur mbi tokë në pozitë horizontale, në hapësirën e betonuar të mbështetur në tri mbajtëset (shalat) nga betoni dhe të shtrënguara me nga dy shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforcimit për të mos lëviz nga ndonjë presionet i mundshëm. Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve bëhet nëpër mes sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur apo kyqur drejt në rezervuar sikurse mund të shihen edhe nga fotot.  <i>Foto 7. Disa prej rezervuarëve të gazit të vendosur në lokacion</i>
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore. Ligjet: • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për VNM Nr. 08/L-181

		• Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 • Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11 • Ligji Nr. 08/L-116 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate • Ligji për mbrojtjen e ajrit Nr. 03/L- 160 • Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 • Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012 • Ligji për tregëtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme Nr. 08/L-018 • Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë Udhëzimit Administrative: • Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit Administrativ (Mmphi) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzim administrativ (MMPHI) Nr. 04/ 2022 për leje mjedisore. • Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës. • Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
--	--	---

		• Udhëzimi administrativ (Ligji Nr. 04/L-230, AME-Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave - MPB. • Udhëzim administrativ mmph Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme. • Udhëzim administrativ Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania “Shala Gas” Sh.p.k, Deponi e gasit të lëngët naftor në zonën kadastrale Suharkë komuna e Suharekë është e përkushtuar më të gjitha funksionet e saj organizative në përmirësimet vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: - Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit - Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit - Respektimin e legjislacionit vendor - Përmirësimin e komunikimit me autoritetet
3.2.2.	Raportimi	//

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Gjatë funksionimit të depnis së gazit të lëngët naftor ndotja e ajrit ndodhë nga makinat ngarkuese dhe shkarkuese të gasit në rrugët
------	---	--

		e depos. Gjatë funksionimit kontinuel të stacionit nga qarkullimet i automjeteve vie deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO2 dhe Pb. Por, krahasuar me komunikacion që zhvillohet në qendra të qytetit dhe në rrugë tjera, numri i kamionëve dhe mjeteve bartëse që shkaktojnë ndotje të ajrit është i pa përfillshim. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të automjeteve në komunikacion në lokacionin e deponise se gazit. Pra, themi që në mënyrë të paevitueshme, në kohën e mbushjeve të bombolave, ka çlirime avujsh në rastin e gasit, çlirime avujsh hidrokarburesh që përmbajnë kryesisht propan, butan, etan, etj. Që të gjithë janë shumë fluror që me rritjen e temperaturës së ambientit, kanë një shkallë avullimi më të lartë. Nëse përmbajta e tyre në ajrin e mikroambientit aty, arrin në një kufi të caktuar përzierje, shkëndija më e vogël jepë eksplozion.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësin e ajërit gjatë fazës së zhvillimit të procesit teknologjik në depoin e gasit të lëngët naftor të kompanisë “Shala Gas” shpk, në kushte normale nuk ka ndonjë ndikim të madhë në cilësin e ajërit. Materiet ndotëse që lirohen si rezultat i avullimit të disa gazërave kimike në ajër është shumë e vogël. Pra, ashtu siç e potencuam edhe më lartë materiet ndotëse lirohen nga karborantet e depozituara në rezervuara dhe gjatë manipulimeve me to, gjithashtu materile ndotëse në nivel më të

		lartë lirohen nga motorat e makinave me djegëje të brëndëshme të cilat ndalen për tu zbrazur apo mbushur me gas natyror. Prandaj si përfundim mund të themi se niveli i liruar i këtyre gazërave dhe materielve ndotëse në ajër është brenda normave të lejuara.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk, në vendin e quajtur Shiroko, zona kadastrale Suharekë, komuna Suharekë, burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten: - Pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjeteve, - Gazërat nga motorat me djegëje të brëndëshme dhe - Avujt e e gazit natyror poashtu dhe - Pluhuri nga sipërfaqet manipuluese të kompleksit.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk, për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër nga avullimi i gasit natyror merrë këto masa mbrojtëse: - Të gjithë gypat ajrues të rezervarëve janë vendosur në lartësi të nevojshme. - Deponia e gazit është i pajisur me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga gazerat.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurin	Në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës: • Gjithmonë bëhet spërkatja e sipërfaqeve punuese, rrugëve sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta. • Kompania posedon bazën/rezervë me ujë për spërkatje.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës nuk bëhet Monitorim i emisioneve.


4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ajrit	Në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës nuk ka bërë matjen e sasisë dhe cilësisë së pluhurit të liruar gjatë punës.
4.8.	Raportimet	Nuk bënë raportime
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së funksionimit me infrastrukturën përcjellëse merren këto masa: Gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve në deponinë e gazit për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër nga avullimi i gazit marren këto masa mbrojtëse: Të gjithë gypat ajruar të rezervarëve janë vendosur në lartësi të nevojshme. Deponia e gazit natyror është pajisur me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga gaset. Bëhet mirëmbajtja e rregullt e rezervuarit i cili përdoret si separator për grumbullimin e gasit mbeturinë. Makinat ngarkuese dhe shkarkuese sipas mundësive shfrytëzojnë karburant sa më kualitativ që të minimizojnë lirim të gazrave në ambientet e deponisë etj.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Reduktimi i rrjedhjeve të gazit • Përdorimi i sistemeve të avancuara të monitorimit (sensorë). • Mirëmbajtja periodike e tubacioneve, valvulave dhe rezervuarëve. • Sisteme për rikuperimin e gazit gjatë ngarkim-shkarkimit. Rritja e efikasitetit energjetik • Pajisje kriogenike më efektive për ruajtje dhe rigazifikim. • Përdorimi i turbinave me efikasitet të lartë dhe rikuperim të nxehtësisë. Integrimi i energjive të rinovueshme

		○ Përdorimi i energjisë diellore për pjesën elektrike të deponisë. ○ Sisteme hibride për ftohjen dhe rigazifikimin.
--	--	--

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Në deponin e gazit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk ujin për shfrytëzim e merr në rrjetin e ujësjellësit, ujë të cilin e shfrytëzon për nevojat e kompanisë. Kompania e ka ndërtuar edhe një rezervuar me rreth 50.000 litra ujë, si masë preventive kundër zjarrit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk nuk përdoret uji në procesin teknologjik, ndërsa ujërat nga shpërlarja dhe sanitaria i shkarkon në rrjetin e kanalizimit.
5.3.	Ndikimet në ujë	Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut ndodhë nëse vie deri te shpërthimi i rezervarëve me gas të vendosur mbi tokë. Gjatë funksionimit kontinuel të deponisë në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vie deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara, i fundërrimeve nga atmosfera, nga rezervari separator i vajti mbeturin, etj.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Në kushte normale deponia e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk nuk pritet të ketë ndikime në ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore. Pra, nuk gjenerojme ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e rrjedhimisht as të ujërave nëntokësore, për faktin se rezervuarët janë të vendosur mbi tokë me shtylla betoni dhe materiali i rezervuarve është çelik i pandryshkshëm me

		ç'rast është evituar mundësia për ndonjë rrjedhje eventuale. Poashtu uji atmosferik dhe ai shpëlarjes shkarkohet në gypin e kanalizimit andaj edhe nuk ka kontakte dhe emisione te ujërave te ndotura.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Në deponin e gasit të lëngët naftor „Shala Gas” Shpk, nuk ka asnjë sistem për trajtimin e ujit, sepse siç e potencuam me lartë uji nuk përdoret në proces teknologjik. Prandaj, uji tjetër që përdoret për nevojat e sanitaris nuk ka nevojë për ndonje trajtim para se ai të shkarkohet në rrjetin e kanalizimit.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania “Shala Gas” shpk deponi e gasit të lëngët naftor, në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, nuk ka bërë matjen e cilësis së ujit të pranuar, e as të shkarkuar gjatë punës së deponis.
5.7.	Raportimi	Nuk bënë raportime
5.8.	Leje ujqre për shfrytëzim të ujit	Kompania “Shala Gas” shpk deponi e gasit të lëngët naftor, në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës nuk posedon leje ujqre për shfrytëzim të ujit.
5.9.	Leje ujqre shkarkimin e ujërave	Kompania “Shala Gas” shpk deponi e gasit të lëngët naftor, në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës nuk posedon leje ujqre për shkarkimim të ujit.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Në kompleksin e depos ndodhet seperatori për vajra me kapacitet minimal prej 15m³ sipas përshkrimit të bërë ne projektin kryesor për ndërtimin e deponisë dhe gjendjes faktike. Ky separator nevojit për pastrimin e bombolave të gasit të cilat grumbullojnë një sasi të vogël të mbetjeve pas një kohë të cakruar. Këto mbetje largohen nga bombola dhe vendosën në separator. Seperator i përmes mureve në disnivele e bënë ndarjen (seperimin) e vajrave/mbetjeve nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pusetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës

pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve. Seperatorori përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Seperatorori është në atë mënyrë që të mund të kontrollohet, pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.



Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet e kulmeve të grumbullohen dhe të derdhën në rrjetin e kanalizimit.

Vajrat nga separatori nuk lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë. Këto vajra grumbullohen në rezervuar/seperator dhe merren nga kompanitë e licencuara për grumbullimin e tyre.

Përveç masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara në pasuset e mësipërme investitori ka ndërmerr edhe këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative pjesa hapësirës operacionale në të cilën bëhet manipulimi me makina spërkatet me ujë.
- Furnizimi me ujë për pije si dhe për nevoja tjera sanitare bëhet nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi i ujit që shfrytëzohet për spërkatjen e pjesës manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarrfikje do të bëhet nga rezervuari.
- Të gjitha ujërat atmosferike nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm grumbullohen dhe kalojnë në rrjetin e kanalizimit.
- Ujërat fekale nga nyjet sanitare përmes gypave dërgohen në rrjetin e kanalizimit.
- Rregullisht bëhet kontrollimi i separatorit të vajit, pas mbushjes bëhet pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji deponohen

		ne ene të posaçme dhe pastaj te dergohen ne trajtim te metejshëm sipas ligjit per trajtimin e materieve te rrezikshme tek kompanitë e licencuara. • Janë vendos kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes se tyre duhet te dërgohen për zbrazje ne deponin regjionale. • Janë vendos enët adekuate për deponimin e mbeturinave te lëngëta.
--	--	---

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Lokacioni i deponis së gasit me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave për toçitje dhe kompresorëve për zbrazjen dhe shpërndarjen e gasit. Sipas gjendjes faktike të deponis së gasit në lokacionin e analizuar mund të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Kompania “Shala Gas” shpk deponi e gasit të lëngët naftor, në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës nuk ka bërë matjen e nivelit të zhurmës gjatë punës në deponin e gasit të lëngët naftor.
6.3.	Raportimet	//

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë fazës së ndërtimit të deponise, ndikim negativ në tokë është paraqitur në aspektin e humbjes së sipërfaqes pjellore të tokës, mirëpo duke pasur parasysh pozitën ekzistuese të lokacionit që e kemi përmend në pasueset e më sipërme që kjo parcellë ndodhet brenda zonës industriale dhe destinimi i saj është për zhvillimin e bizneseve.

		Në fazën e shfrytëzimit të deponisë së gasit ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që vijnë përmes ujërave sipërfaqësore, që vijnë nga sipërfaqja e platosë së deponisë, nga separatori i gasit mbeturinë i cili vije nga pastrimi i bombolave si dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të depos së gasit pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vërtet si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër depos së gasit varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së deponisë, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethinën e deponisë.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve në deponinë e gasit për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë janë marrë këto masa mbrojtëse: • Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative rezervaret nuk janë të vendosur nën tokë, por janë ndërtuar shtyllat nga betoni mbi të cilat janë vendosur rezervaret në mnyrë horizontale. • E gjithë hapësira operationale në të cilat bëhet manipulimi me gas si (mbushja dhe testimi janë të shtuara me beton dhe të mbuluara me kulm. • Furnizimi me ujë për pije si dhe për nevoja tjera sanitare bëhet nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi i ujit që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarrfikje dhe bazeni për raste emergjente furnizohet nga pusi i thellë që është hapur nga pronari.

		• Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm kalojnë në rrejtin e kanalizimit • Vajrat dhe mbetjet nga pastrimi i rezervuarve grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën ne seperator të vajrave. • Ujërat fekale nga nyjet sanitare përmes gypave dërgohen ne gropën septike/kanalizimin e qytetit. • Rregullisht bëhet kontrollimi i seperatorit të vajit, pas mbushjes berë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen ne enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen ne trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme nga kompanit e licencuara. • Janë vendosur kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre dërgohen për zbrazje ne deponin regjionale. • Janë vendosur enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lënget. • Është bërë mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe të pa asfaltuara me barë, drunj dekorativ dhe pemë me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Masat rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit të deponisë së gasit të lëngët naftor do të jenë: Objektivat e rikultivimit Pas përfundimit të aktivitetit pajimet/rezervuarët do të çmontohen dhe në bazë të leverdis do të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe pllato nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të qytetit. Largohen dhe bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi

	të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e deponin e gazit të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethin të lokalitetit. <i>Struktura përfundimtare e sipërfaqeve</i> Pas përfundimit të punimeve, me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera. Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku është vendosur objekti afarist deponia e gazit, pos të lashtave bujqësore periodike të bahet me mbjelljen e fidaneve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, pasi që sipërfaqja është e rrethuar me toka punuese mund të bëhet rekultivimi me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike. <i>Rikultivimi teknik</i> Në bazë të ligjeve të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese apo biznesore, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të projektit, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më parshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike-pedologjike në sipërfaqet e degraduara,
--	---

		duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësit e sanimit të efekteve të pavoritshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet. Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga largimi i pajimeve dhe bazamenteve të betonit të bazës së betonit duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terenit për rikultivim teknik të sipërfaqes tokësore të degraduar. Degradimi i tokës gjatë realizimit të projektit shkon deri në atë masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut prej 30 cm gjerë në 50 cm. <i>Rikultivimi agroteknik</i> Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e lartëcekur. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend. $N_f = S / a \times b$ <i>S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve.</i>
--	--	---

		Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e fidaneve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së silvokulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre . Rikultivimi biologjik Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësore, blegtorale dhe në silvikulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilën e kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet degraduara nga operimi i bazës së betonit janë mbjellja e fidanëve fryt dhënëse, duke e kombinuar me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike.
--	--	---

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Mbeturinat të cilat gjenerohen nga aktiviteti i kompanisë në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontinjer dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale. Vajrat apo mbeturinat e gasit deponohen në

		separator/fuqi dhe ato dorezohen tek ndërmarrjet e licencuara																
		<table><tr><th>Mbeturina</th><th>Emri i mbeturinës</th><th>Shkalla e rrezikshmërisë</th><th>Lloji i deponimit</th></tr><tr><td>05 07 02 05 07 99</td><td>Vajëra/ mbetje nga gasi natyror</td><td>Të rrezikshme</td><td>Separator, Kompani të licencuar për grumbullimin e tyre</td></tr><tr><td>15 01 01 15 01 02 15 01 04 15 01 06</td><td>Paketime nga letra, metali dhe të përziera</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit</td></tr><tr><td>20 03 01 20 03 04 20 01 25 20 01 08</td><td>Mbeturinat komunale</td><td>Jo te rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit</td></tr></table>	Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit	05 07 02 05 07 99	Vajëra/ mbetje nga gasi natyror	Të rrezikshme	Separator, Kompani të licencuar për grumbullimin e tyre	15 01 01 15 01 02 15 01 04 15 01 06	Paketime nga letra, metali dhe të përziera	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit	20 03 01 20 03 04 20 01 25 20 01 08	Mbeturinat komunale	Jo te rrezikshme	Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit
Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit															
05 07 02 05 07 99	Vajëra/ mbetje nga gasi natyror	Të rrezikshme	Separator, Kompani të licencuar për grumbullimin e tyre															
15 01 01 15 01 02 15 01 04 15 01 06	Paketime nga letra, metali dhe të përziera	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit															
20 03 01 20 03 04 20 01 25 20 01 08	Mbeturinat komunale	Jo te rrezikshme	Kontejner për mbeturina/ Deponi e qytetit															
		për grumbullimin e vajrave të përdorura.																
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të kompanisë në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, bën magazinimin e përkohshëm të mbeturinave. Mbeturinat e ngurta komunale, vajrat mbeturinë të gasit vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim edhe pastaj dergohen në deponit regjinale apo në kompanit e licencuar për grumbullimin e tyre.																
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të kompanisë në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, nuk bëhet përpunimin apo riciklimin e mbeturinave.																
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Kompania në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, nuk ka ndonjë kontratë me operatorët tjerë ekonomik për dërgimin e mbeturinave të veqanta për riciklim. Ndërsa varjrat mbeturin merrën nga kompanit e licencuar për grumbullimin e tyre.																

8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani i menaxhimit me mbeturina do të mundëson: - Reduktimin e prodhimit të mbeturinave nga aktiviteti i kompanisë „Shala Gas” - Sh.p.k, deponi e gasit natyror në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, - Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr. 08/L-071, për plotësim ndryshimin e ligjit nr. 04/L-060. - Menaxhimin me mbeturina të ngurta komunale; grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, - Menaxhimin me vajrat mbeturinë të cilat grumbullohen dhe vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruara. - Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimin të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave.
8.6.	Raportimi	Nuk bënë raportim.

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Plani i brendshëm do të përmbanë: Objektivat e Planit: ➤ Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, ➤ Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit,
------	--	---

		➤ Vlerësimi i rrezikut, parandalimi i zjarreve mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale, Qëllimi i planit: Qëllimi i hartimit të këtij plani është: • Zvogëlimi të rrezikut, • Gatishmeria për të marrë vendime të duhura dhe kordinimi i veprimeve (në raste të zjarreve përmasash të mëdha), • Krijimi i prioriteteve për një kordinim sa më efikas në mes të subjekteve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive – zjarreve. Plani i jashtëm: Qëllimet kryesore të këtij Plani janë: Tërheqja e vëmendjes së përdoruesve dhe të autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë së ndodhjes së një aksidenti dhe zbatimit të masave për shmangien e tij, të shmangë efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet), të zvogëlojë shfaqjen e efekteve, të zvogëlojë rrezikun e ndodhjes së aksidenteve ose të zbusë pasojat e aksidenteve kur ato ndodhin. Për realizimin e objektivave të mësipërme, ky plan përmban këto qështje kryesore: ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre, trajnimi i punëtorëve, klasifikimi i territorit sipas kategorise së kërcënimit nga aksidentet, përgjegjësitë.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Në deponin e gasit të lëngët naftor „ Shala Gas ” Shpk në zonën kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, përdoren substancave të rrezikshme kimike, siç është: gasi natyror (metan, etan, propan, butan, etj) këto janë edhe e vetëmja lëndë e parë që përdoret për tregëtim nga deponia e lartëcekur.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe	Masat që janë marrë në raste aksidenti:

	zvogëlimi i pasojave	• Gjithnjë bëhet përdorim i drejt (respektim i rregullave), mbikëqyrje e rregullt dhe mirëmbajtje e pajisjeve. • Është hartuar dhe respektohet rregullorja ku definoohen procedurat për rastet aksidentale, është bërë aftësimi i të punësuarve dhe caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale. • Është ndërtuar sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit, ndërtimi i bazenit me ujë dhe aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë. • Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti në kompleksin e deponisë së gasit e posaçërisht hapësira e mbushjesh dhe testimit, platoja me rrethin dhe gjelbërimi rrethues. • Janë siguruar dhe janë në dispozicion pajisjet doracake kundër shkëndijave. • E tërë sipërfaqja e kompleksit të deponisë së gasit është e rrethuar dhe siguruar nga kompania për sigurim. • Janë shtruar hapësirat gjelbëruese përreth objekteve, sipas kushteve të ndërtimit. • Përdoret sistemi i ujitjes gjatë tërë kohës për minimizimin e grimcave të pluhurit, sidomos gjatë verës. • Përreth perimetrit të objektit dhe rezervuarve të gasit janë ndërtuar kanalet drenazhues për ujërat atmosferike. • Kujdes i veçantë tregohet në krijimin e kushteve të punës sa më komforte për punonjësit. • Janë rritur normat e sigursë në ambientin e punës të deponia e gasit. • Menjanohen rrjedhjet eventuale të gasit nga bombolat dhe është krijuar sistemi kundër eksplodimit.
--	----------------------	---

		• Është siguruar sistemi i aparateve kundër zjarrit dhe janë trajnuar punëtorët për përdorimin e tyre.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	<i>Raporti i sigurisë përmbanë këto të dhëna dhe informata:</i> Shënimet e lokacionit ku gjendet deponia e gasit natyror, duke përfshirë pozitën gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike dhe hidro-grafike, të dhënat mbi terrenin; përcaktimi i stabilimenteve dhe aktivitetëve të tjera të impiantit të cilat mund të paraqesin rrezik nga aksidentet e mëdha; përshkrimi i zonave ku mund të vij deri te efekti domino nga aksidenti i madh, përshkrimi i aktivitetëve kryesore, burimit të rrezikut nga aksidentet e mëdha dhe rrethanave nën të cilat një aksident i tillë mund të ndodhë si dhe përshkrimi i masave preventive të planifikuara; përshkrimi i procedurave, në rend të parë mënyra e punës; <i>Përshkrimi i substancave të rrezikshme, i cili përfshin:</i> Sasinë më të madhe të substancave të rrezikshme që mund të jenë te pranishme në lokacion; vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të substancave të rrezikshme dhe paralajmërimet e rrezikut për njeriun dhe Mjedisin, vërtetimin e substancave të rrezikshme: emërtimi kimik, numri CAS (Chemical Abstract Simbol), emërtimi sipas nomenklaturës IUPAC. Vërtetimi dhe analiza e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mënyra e pengimit. Vlerësimi i pasojave të konstatuara nga aksidenti i madh. Përshkrimi i pajisjeve të shfrytëzuara gjatë sigurimit të stabilimenteve. Përshkrimi detaj i rrjedhjes së mundshme të aksidentëve të mëdha dhe mundësisë së ndodhjes së tyre ose kushtet nën të cilat mund të ndodhin, duke përfshirë përshkrimin e situatës që mund të shkaktojnë në njërin nga zhvillimet e cekura të saj, pa marrë parasysh se a janë shkaktarët brenda stabilimentit ose jashtë tij.

		Të gjitha situatat aksidentale gjatë deponimit dhe distribuimit me gas natyror mund ti kategorizojmë në katër grupe: • Explodimi i avullit të gaseve që janë në gjendje vlimi. • Explodimi i gazrave të reve të pakufizuara. • Explodimet e kufizuara. • Zjarri. Aksidentin e parë duhet përjashtuar nga analiza sepse për të ardhur deri te ky aksident gasi në rezervuar duhet të jetë mbi temperaturën e vlimit. Aksidenti i dytë mund të shkaktohet gjatë manipulimit me gas në deponi ku mund të vie deri te përzierja e avullit të karburanteve me ajrin dhe të krijojnë një përzierje potenciale e cila gjatë koncentracioneve të caktuara dhe energjisë së mjaftuar për aktivizim mund të shkaktojë detonacion explodues me pasoja të mëdha. Mundësia e një aksidenti të tillë është shumë e vogël kur kemi parasysh lokacionin e objektit, sasinë e derivateve, dendësinë e automjeteve të cilat furnizohen me derivate, shpejtësinë e avullimit të karburanteve etj. Sa i përket zjarrit mund të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri kur kemi parasysh faktin se do të ekzistoj projektet kundra zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirren gjatë një aksidenti nga zjarri. Në rastet e aksidentit nga zjarri në lokacionin dhe rrethinën e deponisë së gasit mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi rrethues, kur kemi parasysh toksicitetin e produkteve të djegies, masën e gaztë të produkteve të djegies, shkallën e nxehtësisë, produktet jo plotësisht të djegura të gasit etj.
--	--	--

		Në kuptim më të gjerë, rast aksidental në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës në deponin e gasit natyror është derdhja e gasit deri në atë sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas metodave adekuate. Nëse rregullorja e punës së një deponie të gasit natyror përmban në detale të gjitha aktivitetet dhe veprimet për sanimin e aksidentit nga derdhjet e derivateve, mund të konstatojmë se derdhjet e gasit nuk mund të rrezikojnë mjedisin. Në pajtim me nenet e rregullores mbi metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë nga aksidenti kimik dhe nga ndotja e mjedisit, masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza: • Identifikimi i rrezikut • Analiza e pasojave • Vlerësimi i rrezikut Identifikimi i rrezikut nënkupton procesin e mbledhjes së të dhënave mbi materiet e rrezikshmërisë në proces si dhe verifikimin e të gjitha pikave kritike të procesit dhe stabilimenteve. Përveç identifikimit të materieve të dëmshme në proces, në fazën e parë të analizës së rrezikshmërisë duhet bërë identifikimin e burimeve të rrezikut. <i>Analiza e trungut të ngjarjeve</i> Ngjarjet të cilat pasojnë në rastet aksidentale mund të kenë karakteristika të ndryshme. Në vijim do të paraqesim disa nga mundësit e zhvillimit të ngjarjeve gjatë aksidentit. • Reja e formuar lëviz te poshtë: *inicimi ndodh menjëherë pas formimit të sferës së nxehtë *inicimi ndodh më vonë, krahas shkaktimit të zjarrit ose eksplodimit të resë.
--	--	---

*nuk vjen deri të inicimi.

- Reja e formuar lëviz përpjetë:

*inicimi ndodh menjëherë krahas formimit të resë së zjarhtë

*largohet nga rezervari dhe vjen deri të inicimi ose eksplodimi i resë

*nuk vjen deri te inicimi.

Ngjarja në tërë rezervarin

Në rast se aksidenti e përfshin tërë rezervarin, ekzistojnë dy mundësi:

- a) aksidenti në rezervarin e nxehtë
- b) aksidenti në rezervarin e ftohtë


Inicimet e mundshme në tërë rezervarin janë:

- sfera e zjarrit
- zjarri
- eksplodimi i resë dhe
- disperzioni i resë pa inicim

Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrina në rezervar)

Ngjarjet e mundshme në këtë rast janë:

- formimi i resë e cila lëvizë
- inicimi me krijimin e resë së avullit që eksplodon
- shkaktimi i zjarrit
- pa inicim.



		Analiza e pasojave Analiza e pasojave është faza e dytë e analizës së rreziqeve dhe për qëllim parashikon vëllimin e pasojave të mundshme të aksidentit dhe nivelin e dëmit. Pasojat kryesore të mundshme të aksidentit në kompleksin e depones së gasit natyror janë: • BLEVE (Bilong Liquid Expanding Vapor Explosions – eksplodimet e avullit ekspandues të lëngut të vluar): • Zjarri • Dispergimi i resë pa inicim BLEVE Masa e BLEVE-së, e cila merret të jetë 80% të vëllimit të rezervuarit. Supozohet se sfera e zjarrit e ka formën sferike dhe është afër tokës. Për rezervarin me vëllim prej $10\text{m}^3 \times 0.8$ (80% të vëllimit të rezervuarit) diametri i sferës së zjarrtë mund të jetë gjerë ne 10m. Kohëzgjatja e sferës është më pak se 10s, në këto rrethana mund të shkaktohen lëndime të djegies se shkallës së tretë në pjesët e zbuluara të lëkurës. Zjarri në rezervar Zjarri në rezervuar shkakton rrezatim termik, që paraqet rrezik për njeriun dhe për objektet përreth. Për të kuantifikuar efektin e veprimit të zjarrit është përvetësuar që doza e rrezatimit 1000 njësi (kW/m^3) shkakton djegie të konsiderueshme në lëkurën e zbuluar të njeriut. Në tabelën ne vijim është dhënë varësia e dozës së rrezatimit nga diametri i zjarrit. <table><tr><th>Diametri</th><th>Doza (njësi)</th></tr><tr><td>1.1 D</td><td>3.000</td></tr><tr><td>1.2 D</td><td>2.300</td></tr><tr><td>1.3 D</td><td>100</td></tr><tr><td>1.4 D</td><td>200</td></tr></table>	Diametri	Doza (njësi)	1.1 D	3.000	1.2 D	2.300	1.3 D	100	1.4 D	200
Diametri	Doza (njësi)											
1.1 D	3.000											
1.2 D	2.300											
1.3 D	100											
1.4 D	200											

		(Për njerëzit në objekte)
	Deri në 1.1 D	2.300
	Mbi 1.1 D	0
	Vlerësimi i rrezikut	
	Rreziku nga aksidenti vlerësohet në bazë të gjasave të ndodhjes së aksidentit dhe vëllimit të pasojave.	
	6.3.1. Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit	
	Gjasat e ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjajshme në vendet tjera dhe të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve. Në tabelën në vijim janë paraqitur gjasat e ndodhjes së aksidenteve sipas të dhënave të publicuara në simpoziumin ICHEME të mbajtur në Budapest në vitin 1991.	
	<u>Ngjarja</u>	<u>Gjasat</u> <u>Distanca (m)</u>
	<u>Derdhje të vogla</u>	<u>Të mëdha</u> <u>10</u>
	<u>Çarja e gypave, lidhëseve</u>	<u>Të vogla</u> <u>10 - 100</u>
	<u>Çarja e rezervarit dhe sfera e zjarhtë</u>	<u>Shumë të vogla</u> <u>Mbi 100</u>
	<u>Çarja e rezervarit VCE</u>	<u>Tejet të vogla</u> <u>Mbi 100</u>
	<u>Çarja e rezervuarit, formimi i resë</u>	<u>Tejet të vogla</u> <u>Mbi 100</u>
	Vlerësimi i pasojave të mundshme	
	Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrihen në bazë të dhënave të përfituara me analizën e cenueshmërisë.	
	Me anë të analizës se cenueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cenueshme në rrethinën e burimit potencial të aksidentit:	
	• Të punësuarit në kompleks • Pjesëmarrësit në trafik në rrugë • Objektet afariste dhe të banimit	
	Objektet e banimit janë të larguar mbi 650m	

9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Në rast të aksidenteve mjedisore-zjarri, mbrojtja planifikohet të bëhet evakuimi i detyrueshëm i personave në rrezik nga ndërtesa ku ka ndodhur zjarri kritike për të siguruar objektivin themelor të mbrojtjes së njerëzve dhe ndërtesës nga zjarri. Ndodhja aksidentale e zjarrit shkakton një situatë mjaft stresuese, dhe reagimi i njerëzve është i paparashikueshëm. Për dallim nga çdo ditë duke e lënë objektin në përdorim normal, evakuim të detyruar në rast një zjarr ndodh papritur, pa mundësinë e parashikimit të tij. Elementet paniku, i cili është i pranishëm në situata të tilla, vetëm e vështirëson evakuimin. Procedurat e evakuimit në rast zjarri: ➤ Sigurohet evakuimin i sigurt të personave të cënueshëm dhe pajisjeve të vlefshme, ➤ Shuarja dhe lokalizimi i zjarrit dhe ruajtja e integritetit dhe stabilitetit të ndërtesës. Parandalimi i zjarrit në deponin e gasit natyror zbatohet në mënyrë më efektive nga aplikimi materiale jo të djegshme në elemente strukturorë kudo që të jenë të jetë e mundur. Në këtë drejtim, bëhet zëvendësimi i materialit që është më lehtë i ndezshëm ose ka një fuqi termike më të lartë, me një material që ka një temperaturë më të ulët ndezja dhe prodhimi më pak i nxehtësisë. Një masë aktive gjithashtu përfshin zvogëlimin sasia e përgjithshme e ngarkesës masive të zjarrit në objekt, duke e zvogëluar atë temperatura e procesit termik, përqendrimi i zjarrit, temperatura e flakës dhe shkëndijat etj, dhe duhet pasur kujdes edhe për mbajtjen e burimit të nxehtësisë në afërsi të karburantit të temës. Shuarja e flakës së pilotit (e vogël - fillestare) pas humbjes kontrolli i zjarrit është i mundur me mjete të përshtatshme, ndonjëherë edhe me anë të shuarjes një këpucë e zakonshme pranë zjarrit. Për të kontrolluar zjarrin gjatë fillimit faza dhe likuidimi i saj i hershëm është zgjidhja më e mirë duke
------	--------------------------------	--

	përdorur pajisjet mobile kunder zjarrit te cilat mund të përdoret nga të gjithë personat. Nëse zjarri nuk arriti të shuhet me një pajisje "S" ose "CO₂", në raste te tilla nevojitet me shumë kontroll i dhe nevojitet më shumë ndërhyrje - duhet të përfshihen me shume njerëz me më shumë pajisje (makineritë fillestare të zjarrit dhe rrjeti i brendshëm hidrant). Pas kësaj mund të fillojë me evakuimi, duke pasur parasysh që një numër personash nuk janë kompetent për ekspertin ndërhyrja, dhe në shumë raste ato pengohen nga paniku i tyre ndërhyrje. Për të siguruar evakuimin efikas është i nevojshëm të sigurojë integritetin e strukturës në komunikimet rrugore dhe ambientin karakteristikat nën faktorin e rrezikut në kohën e evakuimit. Një zjarr zjarri duhet të japë mundësinë e suksesit edhe kur pika qendrore është e madhe dhe disa dhjetëra m². Në këtë fazë, instalimet e shuarjes së qëndrueshme përdoren me pjesëmarrjen e anëtarëve të një brigade profesionale zjarri. Procedura e shuarjes kryhet në fazat vijuese: Faza e Parë I - Zjarri përfshin fikjen e energjisë elektrike dhe hyrjen e zjarrfikësve me pajisje të mbajtura me dorë ose ujë nga një rrjet hidrant. Për përdorimin e aparateve të zjarrit të tipit 6 dhe 9 kg të tipit S veprimet duhet të kryhen në rendin e mëposhtëm: Siguroni pajisjen në vend sa më shpejt që të jetë e mundur Zjarri, tërheq levën në valvulën e pajisjes, godet levën e luajtshme në valvulën e pajisjes me pëllëmbën e dorës, prisni 5 sekonda, dhe ktheni grykën drejt zjarrit dhe shtypni gungën plotësisht. Koha e veprimit është 18 sekonda dhe rrezja e është 4 m. Për të përdorur një zjarrfikës 5 CO₂. - Kompania ka siguruar pajisjet kundër zjarrit
--	--

		- Janë trajnuar shumica e punëtoreve për përdorimin e pasijeve kundër zjarrit, - Janë marrë masa për sigurinë e përgjithshme kundër pëlcitjes aksidentale apo të qëllimshme të zjarrit.
--	--	--

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Në rastet se vërehet se kemi funksionim jo stabile të Pikës të karburanteve, bëhet ndërprerja momentale e punës dhe fillon kontrollimin për të gjetur shkakun, për çfarë arsyeje nuk kemi rrjedhje normale të punës. Pas gjetjes së defektit dhe rikuperimit të tij, bëhet testimi dhe lëshohet në punë deponia e gazit. Ndërsa në kushte normale nuk ka ndërprerje momentale e punës së deponise se gazit përveç nese kemi ndërprerje momentale të rrymës elektrike.
10.2.	Ndërprerja e punës	Nuk ka ndalje të punës

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT
Gjatë funksionimit kontinuel të deponisë së gazit të lëngët natyror pronë e kompanisë “Shala Gas” Sh.p.k , në zonën industriale Shirokë, zona kadastrale Suharekë komuna e Suharekës, kjo deponi me respektimin e plotë të udhëzimeve të dhëna në raportin e VNM-së, aplikacionin e Lejës Mjedisore, akteve ligjore dhe nënligjore tjera të parapara për këtë fushë, atëherë ndikimi i mundshëm i ndotjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut konsiderohet të jetë minimal.

Personi përgjegjës për mjedis
Emri mbiemri
Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati
Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë
Emri mbiemri
“Shala Gas” Shpk
Nënshkrimi

Shtojca 1.

